



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:209936

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05296303

KA.nr. 441/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “VBH Kosovo” L.L.C., me seli në Drenas, me numër unik identifikues ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V. Rr., avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Komuna e Drenasit, për shkak të anulimit të Vendimi nr. 01-431/01-45913 i datës 12.09.2023, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 25.01.2024, në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurit, më datë 07.02.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “VBH Kosovo” L.L.C. me seli në Drenas, ANULOHET Vendimi nr. 01-431/01-45913 i datës 12.09.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Ankesa ndaj Taksës Komunale pranë të paditurit Komuna e Drenasit.
- II. Ndryshohet pika I e Aktvendimit 05nr.431/01-27654 i datës 09.06.2023, i nxjerrë nga i padituri Komuna e Drenasit – Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, ashtu që:
 - a. Mbetet në fuqi taksa komunale e caktuar në shumën prej 250€ për vitin fiskal 2023 për “VBH Kosovo” L.L.C.;
 - b. Anulohet pjesa e konstatimit lidhur me borxhin total në shumë prej 3,550.00€.
- III. Ky Aktgjykim zëvendëson aktin e ndryshuar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Shtyrja e ekzekutimit të Aktvendimi 05nr.431/01-27654 i datës 09.06.2023, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr. 441/23 i datës 11.10.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “VBH Kosovo” L.L.C., përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Aktvendimit 05nr.431/01-27654 të datës 09.06.2023 dhe Vendimit nr. 01-431/01-45913 të datës 12.09.2023, me të cilin ishte aprovuar pjesërisht ankesa e ushtruar ndaj Aktvendimit 05nr. 431/01-27654 të datës 09.06.2023 ku paditësit i ishte caktuar taksa Komunale në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2023 si dhe borxhi total në vlerë prej 3,550.00€ për ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të Komunës së Drenasit. Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke shtuar se në këtë rast gjyqësor janë tri situata të cilat duhet të sqarohen sa i përket pretendimeve të palës së paditur dhe vet objektit të shqyrtimit i cili është atakuar edhe me padi. E para është çështja e periudhës kontestuese e viteve të operimit nga e paditura në territorin e Komunës së Drenasit për vitet 2008-2012 ku është vërtetuar edhe nga Komisioni i Ankesave se paditësi nuk ka operuar në këtë territor dhe gabimisht është faturuar për këtë periudhë. Situata e dytë është çështja e faturimit pasi që rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba ka hyrë në fuqi në vitin 2020 dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore pas viti 2020 çdo faturim që është bërë nga ana e të paditurës, paditësi i është përmbajtur udhëzimeve dhe ka bërë të gjitha pagesat e taksave. Po ashtu për vitet 2022 dhe 2023 të njëjtët pagesa janë përmbushur ashtu siç janë udhëzuar me vendim. Situata e tretë dhe kontestuese është çështja e faturimit pasi që rregullorja ka hyrë në fuqi, pra vitin 2020 ku e paditura në bazë të kësaj rregulloreje ka kërkuar nga paditësi që t’i përmbush obligimet edhe për periudhën 2013-2019 duke u bazuar në këtë rregullore gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale duke kërkuar nga paditësi që të bëjë pagesën në mënyrën retroaktive mbi bazën e kësaj rregulloreje nr.12-400-16587 të datës 27.05.2020 e cila veprimin ligjor dhe efektin juridik e arrin që nga momenti i hyrjes në fuqi ashtu siç është përcaktuar edhe në nenin 28 të saj e njëjta ka hyrë në fuqi 15 ditë nga dita e shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL si dhe 7 ditë nga publike në veb faqen zyrtare të Komunës. E paditura gabimisht i është referuar kësaj rregulloreje dhe neneve përkatëse edhe pse në nenin 28 qartëson se kur e njëjta fillon të zbatohet mirëpo për arsye se në periudhën për të cilën është tarifuar subjekti afarist, e njëjta nuk ka qenë në fuqi dhe nuk ka pasur detyrim ligjor ndaj subjekteve afariste. Pra, siç mund të vërtetohet e njëjta rregullore nuk mund të ketë fuqi retroaktive dhe nuk mund të prodhoj pasoja juridike për paditësin, andaj duke u bazuar në deklaratimet e mësipërme shihet çartë se e paditura ka bërë zbatim të gabuar të kësaj rregulloreje. Ndër të tjerash i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim duke miratuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “VBH Kosovo” L.L.C si të bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës me nr. 01-431/01-45913 të datë 12.09.2023 si i pa lejuar si dhe i pa bazuar.

I padituri përmes përgjigjes në padi të ushtruar më 07.12.2023 ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë në përputhje me dispozitat ligjore, kjo për faktin se me vendimin e atakuar nga pala paditëse është aplikuar rregullorja komunale për plotësim dhe ndryshim për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoba nr. 12-400-16587 të datës 27.05.2020 e aprovuar nga Kuvendi Komunal i Drenasit, rregullore kjo e cila ka qenë në fuqi në momentin e ngarkimit të taksës komunale dhe në rastin konkret nuk ka pasur të bëjë me veprim retroaktiv, ashtu që edhe borxhi i evidentuar si në aktvendim dhe në kartelën financiare për vitet paraprake është ngarkuar me të njëjtën rregullore e cila ka qenë në fuqi në momentin e shqiptimit të kësaj takse. Po ashtu, gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aktvendim 05nr.431/01-27654 të datës 09.06.2023; Kartela financiare për kompaninë “VBH Kosovo” L.L.C për periudhën 01.01.2008 deri 01.01.2023; Vendim nr. 431/01-45913 i datës 12.09.2023; Kartela financiare për kompaninë “VBH Kosovo” L.L.C e lëshuar me datë 12.09.2023; Certifikata e regjistrimit të biznesit për “VBH Kosovo” L.L.C dhe informatat e biznesit; Vendim për ndërrimin e adresës i datës 14.03.2013; Aneks statuti i datës 14.03.2013; Historiku i biznesit i lëshuar nga ARBK për “VBH Kosovo” L.L.C.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë dhe në padi si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se me Aktvendim 05 nr.431/01-27654 të datës 09.06.2023, i padituri i kishte caktuar taksën Komunale të evidentuar në Gjendjen e kartelës nr. 3958 në shumën prej 250.00€ për vitin fiskal 2023 si dhe borxhin total në vlerë prej 3,550.00€ për ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të Komunës së Drenasit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur me datë 31.08.2023 kishte ushtruar ankesë tek i padituri Komuna e Drenasit – Komisioni për Ankesa ndaj Taksës Komunale (KATK), ankesë e cila ishte aprovuar pjesërisht si e bazuar përmes Vendimit të datës 12.09.2023 i protokolluar me numër 01-431/01-45913, ashtu që ka rekomanduar Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik (DZHE) të kësaj komune që të ri shikoj historiatin e biznesit nga viti 2008 deri në vitin 2012 pasi që i

njëjti kishte dëshmuar se nuk ka vepruar në Komunën e Drenasit, njëherit ka obliguar DZHE që ta korrigjoj Kartelën Financiare të “VBH Kosovo” L.L.C. duke lënë borxhin për vitet fiskale 2013-2023.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.”*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat kanë mbështetje në gjendjen faktike dhe janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Kartela financiare për kompaninë “VBH Kosovo” L.L.C për periudhën 01.01.2008 deri 01.01.2023, gjykata konstatoi se Komuna e Drenasit kishte faturuar paditësin me taksën për vitin 2023 në vlerë prej 250.00€ ndërsa si borxh të mbetur kishte faturuar shumën prej 3,550.00€.

Nga Kartela financiare për kompaninë “VBH Kosovo” L.L.C e lëshuar me datë 12.09.2023, gjykata konstatoi se paditësi kishte bërë pagesën e taksës për vitin 2023 dhe për vitin 2022, e po ashtu ishte bërë korrigjimi i Kartelës Financiare për periudhën 2008-2012, ashtu që si borxh të mbetur kishte faturuar vlerën prej 1,800.00€.

Nga Certifikata e regjistrimit të biznesit për “VBH Kosovo” L.L.C dhe informatat e biznesit, gjykata konstatoi se i njëjti është i regjistruar na Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve me datën 09.10.2007.

Nga Vendim për ndërrimin e adresës i datës 14.03.2013, gjykata konstatoi se kompania “VBH Kosovo” L.L.C kishte bërë ndërrimin e adresës së selisë nga Fushë Kosova Rr. “Nëna Terezë”, pn. në Drenas, Parku Industrial.

Nga Aneks statuti i datës 14.03.2013, gjykata konstatoi se ishte bërë ndryshimi i statutit në lidhje me ndërrimin e adresës së selisë së kompanisë.

Nga Historiku i biznesit i lëshuar nga ARBK për “VBH Kosovo” L.L.C, gjykata konstatoi se kompania në fjalë është e regjistruar në ARBK me datë 09.10.2007 dhe për të njëjtin ekziston historiku i përfaqësuesve dhe aktiviteteve të biznesit.

Nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata i vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pasi që i padituri Komuna e Drenasit me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues 05nr. 431/01-27654 të datës 09.06.2023 gabimisht kishte zbatuar dispozitat ligjore duke e faturuar paditësin me borxhin në vlerë prej 3,350.00€, e të cilin KATK përmes Vendimit 01nr. 431/101-45913 të datës 12.09.2023 kishte bërë korrigjimin vlerës së borxhit të mbetur në shumën prej 1,800.00€ për ushtrimin e veprimtarisë së kompanisë “VBH Kosovo” L.L.C brenda territorit të Komunës së Drenasit në periudhën kohore 2013- 2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve kontestuese në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i cili përcakton se: *“Kuvendi i komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij. 12.2 Aktet e kuvendit të komunës vlejnë në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë: a) statutin e komunës; rregulloren e punës; c) rregulloret komunale; dhe d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.”* në lidhje me nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i cili përcakton se: *“Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të përcaktojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare për marrjen ose mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Rregullorja e sipërpërmendur mund të vendosë një skemë tarifore e cila përcakton taksa të ndryshme për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste. Të gjitha taksat për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale. Skema tarifore dhe rregullat nuk duhet të përcaktojnë taksa të ndryshme për shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme afariste.”*

Po ashtu, gjykata iu referua edhe dispozitës së nenit 26 të Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 12-400-16587 të datës 27.05.2020 i cili përcakton se: *“Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Komunës së Glllogocit për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale nr. 12Nr.030-19516 të dt. 06.04.2018.”* lidhur me nenin 28 të po kësaj rregullore ku përcaktohet se: *“Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e*

regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.”

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjeti se paditësi përmes Vendimit të datës 14.03.2013 kishte ndërruar adresën e selisë dhe atë duke kaluar nga Komuna e Fushë Kosovës në Komunën e Drenasit si dhe i njëjti kishte bërë pagesën e taksës për vitin fiskal 2022 dhe 2023, ashtu pas nxjerrjes së Vendimit nr. 01-431/01-45913 të datës 12.09.2023 DZHE përmes Kartelës Financiare të datës 12.09.2023 ka faturuar paditësin me borxh për vitet fiskale 2013 deri 2023 në vlerë prej 1,800.00€ edhe pse Rregullorja për ndryshim- plotësim për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 12-400-16587 i datës 27.05.2020 nuk ka qenë në fuqi në kohën për të cilën ishte faturuar paditësi si dhe e njëjta kishte shfuqizuar Rregulloren së Komunës së Gllogocit për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale nr. 12 Nr.030-19516 të datës 06.04.2018, duke lënë të kuptohet se i padituri Komuna e Drenasit ka zbatuar gabimisht dispozitat e lartcekura duke tarifuar paditësin edhe për periudhën kohore kur nuk ka qenë në fuqi rregullorja dhe për të cilën nuk ka pasur detyrim ligjor.

Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës duke u bazuar në nenin 2 paragrafi 3 të Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 12-400-16587 të datës 27.05.2020 (e miratuar nga MAPL me datën 27.07.2023) e cila përcakton se: *Drejtorati për Zhvillimin Ekonomik shpërndarjen e faturave duhet ta bëjë nga data 1 maj deri me datën 30 qeshor. Të gjitha bizneset në momentin e pranimit të faturës, janë të obliguar që brenda 30 ditë të bëjnë pagesën e obligimeve*” dhe rrjedhimisht Komuna e Drenasit për çdo subjekt afarist që vepron brenda territorit të saj nxjerr vendim çdo viti kalendarik duke e faturuar vetëm për atë vit fiskal, ashtu që bizneset nuk mund të faturohen për vitet paraprake dhe të bëhet mbledhja e të gjitha borxheve të akumuluar ndërr vite dhe si e tillë të veprojnë në mënyrë retroaktive. Rregullim të njëjtë të faturimit të taksës e kanë paraparë edhe rregulloret e mëhershme të kësaj Komune ku neni 13 paragrafi 5 i Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba 01-030-69954 i datës 09.12.2019 çështjen e faturimit të bizneseve e ka rregulluar njësoj duke lënë të nënkuptohet se Komuna e Drenasit për periudhën 2013 deri 2023 është dashur që për çdo vit të nxjerr nga një vendim për faturimin e bizneseve me detyrimin për taksa për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në territorin e komunës.

Tutje, gjykata vlerësoi se tarifimi i paditësit për vitin fiskal 2023 ishte bërë në përputhje të plotë me dispozitat e lartcekura për tarifim të bizneseve për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve brenda territorit të Komunës së Drenasit, ndërsa për shkak se e njëjta është dashur që të nxjerr

akte administrative të veçanta për çdo vit fiskal që ka vepruar subjekti afarist brenda komunës duke u bazuar në rregulloret që kanë qenë në fuqi, i padituri nuk është dashur që për të bëjë përlllogaritjen e borxhit total për periudhat kohore që paditësi nuk ka bërë pagesën e taksës dhe atë duke u bazuar në rregulloren e cila nuk ka qenë në fuqi për periudhat kontestuese.

Po ashtu, veprimet e të paditurit janë edhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, pasi që paditësi duke pasur parasysh që pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Ndryshimin-Plotësimin për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nr. 12-400-16587 të datës 27.05.2020 ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga rregullorja në fjalë dhe ka bërë pagesën e taksës Komunale për vitin fiskal 2022 dhe 2023, ndërsa veprimi i të paditurit që të faturoj borxhin total për vitet 2013 deri 2023 (duke përjashtuar vitin fiskal 2020 dhe 2021 ku subjektet afariste kanë qenë të liruar nga detyrimi për pagimin e taksës në bazë të vendimeve të qeveris për lirim nga pagesa e taksës) duke u mbështetur në Rregulloren e vitit 2020, kanë qenë në kundërshtim me përcaktimet e këtij parimi që: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.”* si dhe me parimin e proporcionalitetit që përcakton se: *“Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit.”*

Andaj, gjykata vendosi të anuloj në tërësi vendimin e shkallës së dytë në kuptim të nenit 43 të LKA i cili përcakton se: *“1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative.”* si dhe duke iu referuar nenit 46 par. 4 të LKA-së që përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.”*, ashtu që gjykata vendosi që të ndryshoi Aktvendimin 05nr.431/01-27654 të datës 09.06.2023 sa i përket konstatimit lidhur me borxhin total në shumë prej 3,550.00€, ndërsa la në fuqi taksën komunale për vitin fiskal 2023 në vlerë prej 250.00€ dhe vendosi që ky aktgjykim të zëvendëson aktet e atakuara.

Gjykata la në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit 01-431/01-45913 të datës 12.09.2023, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr. 441/23 i datës 11.10.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.441/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.